



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jed-nica Org Unit	01
Nr. Prot. Org Prot. Prot.No	05-8553
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 11 -
Data: Datum: Date:	28/12/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.230/XII/2023

Datë:27.12.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Shtojcën 1, pika 6.1 Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

- I. Aprovohet plani i veprimit për zhvillim të edukimit shëndetësor në nivel spitalor për sëmundjet kronike jo ngjitëse në përputhje me planin kombëtar të veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor për vitin 2024
- II. Shtojce e këtij vendimi është, Plani i Veprimit për zhvillim të edukimit shëndetësor në nivel spitalor për sëmundjet kronike jo ngjitëse në përputhje me planin kombëtar të veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor për vitin 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vita
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

**PLANI PËR ZHVILLIM TË EDUKIMIT SHËNDETËSOR NË NIVEL
SPITALOR PËR SËMUNDJET KRONIKE JO NGJITËSE NË PËRPTHJE ME
PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PROMOVIM DHE EDUKIM
SHËNDETËSOR**

Prishtinë, 2023

1.	HYRJE	4
1.1.	Roli i Spitalit në promovimin shëndetësor	4
1.2.	Procesi i zhvillimit të Vlerësimit të Standardeve SPSH.....	5
2.	METODOLOGJIA DHE ECURIA E PUNES.....	6
2.1.	Vlerësimi i situatës.....	6
2.2.	Ecuria e punës.....	8
2.3.	Mbikqyrja e procesit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara	9
3.	PLANI I AKTIVITETEVE VJETORE	10

1. HYRJE

Iniciativa e Spitaleve dhe Klinikave që Promovojnë Shëndetin, është një rrjet i institucioneve shëndetësore i mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e cila u themelua për promovimin e Kartës së Otavës për Promovimin e Shëndetit.

Lëvizja “Mjediset e shëndetshme” e dalur nga strategjia e OBSH-së për Shëndetin për të Gjithë vepron që nga viti 1980. Kjo lëvizje karakterizon vendin ose kontekstin social në të cilin njerëzit përfshihen në aktivitete të përditshme, në të cilat faktorët mjedisor, organizativ dhe personal ndërveprojnë për të ndikuar në shëndetin dhe mirëqenien. Shembuj të mjediseve të shëndetshme përfshijnë shkollat, vendet e punës, spitalet, fshatrat dhe qytetet e mjediset tjera.

Qasja “Spitalet për Promovimin e Shëndetit” të OBSH-së synon të integrojë vlerat dhe standardet e promovimit të shëndetit në strukturën dhe kulturën e spitalit, duke përfituar pacientët, stafi dhe komuniteti. Promovimi i shëndetit duhet të jetë një pjesë qendrore e punës spitalore, duke përfshirë edukimin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve, shërbimet e rehabilitimit dhe fuqizimin e pacientëve, të afërmeve dhe punonjësve. Për të përmbushur kërkesën në rritje për këto shërbime, spitalet duhet të zgjerojnë fushën e tyre dhe të ofrojnë aktivitete më sistematike, duke përfshirë edukimin terapeutik dhe këshillimin motivues, duke vënë në theks kushtet e punës për të përmirësuar shëndetin, efikasitetin dhe cilësinë e kujdesit të personelit¹.

Spitalet që promovojnë shëndetin dhe shërbimet shëndetësore (SPSH), orientojnë modelet e tyre të qeverisjes, strukturat, proceset dhe kulturën për t'i optimizuar përfitimet shëndetësore të pacientëve, stafit dhe popullatës së shërbyer dhe për t'i mbështetur shoqëritë e qëndrueshme. Ato fokusohen kryesisht te pacientët, familjarët, nevojat e grupeve të cënueshme, personeli shëndetësor i spitalit, popullata e përgjithshme dhe mjedisi që i rrethon.

Historikisht, spitalet kishin zhvilluar aftësinë për diagnostikimin, trajtimin dhe mbështetjen e pacientëve ndërsa sot promovimi i shëndetit konsiderohet si një ndër fushat kryesore të funksionimit të tyre. Plotësimi i standardeve për rrjetin e Spitaleve Promovuese të Shëndetit, përfshinë aktivitete të edukimit dhe promovimit shëndetësor që kontribuojnë në agjendën e shëndetit publik dhe që fokusohen në parandalim, kujdes të plotë dhe të integruar, përfshirje të komunitetit, barazi në shëndet, praktikë e bazuar në dëshmi, arsimim dhe edukim shëndetësor, mirëqenie e personelit shëndetësor.

1.1. Roli i Spitalit në promovimin shëndetësor

Promovimi i shëndetit është çështje thelbësore e cilësisë në spitale, dhe për këtë arsye duhet të përfshihet në punën e përditshme.

Spitalet luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese. Me rritjen e prevalencës së sëmundjeve kronike

¹ WHO, Standards for Health Promotion in Hospitals, 2004

dhe të lidhura me stilin e jetës, kërkohet një fushëveprim më i zgjeruar dhe sigurim sistematik i aktiviteteve.

Edukimi terapeutik, strategjitë që u mundësojnë pacientëve të marrin rol aktiv në menaxhimin e sëmundjeve kronike ose në këshillimin motivues, mund të mbështesin rezultate më të mira shëndetësore spitalore.

Spitalet gjithashtu duhet të vënë theks më të madh në kushtet e punës me qëllim të përmirësimit të shëndetit të stafit dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së kujdesit.

Që nga viti 2021, Rrjeti ndërkombëtar i SPSH përbëhet nga më shumë se 600 spitale dhe institucione të shërbimit shëndetësor nga 33 vende.

1.2. Procesi i zhvillimit të Vlerësimit të Standardeve SPSH

Strategjia kryesore për përmirësimin e cilësisë në kujdesin shëndetësor është **vendosja e standardeve** të cilat sigurojnë kornizën për vlerësim si dhe ofrojnë mundësi për zhvillim dhe përmirësim të shërbimeve.

Një grup punues i përbërë nga anëtarë nga Sekretariati të SPSH dhe Rrjeti Gjerman i SPSH përmbodhi dhe sintetizoi përgjigjet e marra nga 11 Rrjetet e SPSH bazuar në atributet për vlerësimin e elementeve të matshme duke u fokusuar në vëzhgimin e drejtpërdrejtë, analizimin e dokumentacionit ekzistues duke u bazuar në fakte, dokumente ose burime të tjera që ndihmojnë në matjen/vëzhgimin/argumentimin e zbatimit të standardit.

Verzioni aktual, "Standardet 2020 për spitalet dhe shërbimet shëndetësore që promovojnë shëndetin", përfshin ~~5 standarde, 18 nënstandarde dhe 85 deklarata, ndërsa për~~ ~~metodën vlerësimi fillestar në dy spitale në Kosovë (Gjakovë dhe Pejë), janë përzgjedhur: 5~~ standarde, 12 nënstandarde dhe 20 deklarata si vijon:

Standardi 1. Demonstrimi i angazhimeve organizative për SPSH, me dy nënstandardet: Lidërshipi dhe Politika.

Standardi 2. Sigurimi i qasjes në shërbime me dy nënstandardet: E drejta dhe disponueshmëria dhe Pranueshmëria socio-kulturore.

Standardi 3. Përmirësimi i përqëndrimit të kujdesit shëndetësor me njerëzit në qendër dhe përfshirja e përdoruesve, me pesë nënstandardet: Përgjegjshmëri ndaj nevojave të kujdesit, Praktika e përgjegjshme e kujdesit, Komunikimi me pacientin dhe ofruesin, Mbështetja e ndryshimit të sjelljes së pacientit dhe fuqizimit të pacientit, Bashkëpunimi me ofruesit e kujdesit.

Standardi 4. Krijimi i një vendi të shëndetshëm pune dhe një mjedisi të shëndetshëm me një nënstandard: Mjedis i shëndetshëm.

Standardi 5. Promovimi i shëndetit në një shoqëri më të gjërë me dy nënstandarde: Nevojat shëndetësore të popullatës dhe Shëndeti mjedisor.

2. METODOLOGJIA DHE ECURIA E PUNES

Me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit, që është prioriteti kryesor në dokumentet strategjike të Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Planin për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2023-2025, përmes së cilit synon të zhvillojë një qasje të integruar që do të ndihmojë në parandalimin e sëmundjeve dhe uljen e kostos së shëndetit në të ardhmen, si dhe me Vendimin Nr.05-3373, datë 02.06.2023 ka aprovuar Planin e Veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor gjatë periudhës 2023-2025.

Në këtë plan të veprimit është paraparë aktiviteti: Krijimi i një rrjeti kombëtar për Spitalet e Shëndetshme dhe bashkëpunimi me shoqatat rajonale dhe kombëtare të Spitaleve dhe komunave për të siguruar që shëndeti të përfshihet në agjendat e tyre në kuadër të Objektivës specifike: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial me qëllim të përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies si dhe adresimit të përcaktuesve socialë të shëndetit.

Në zbatim të planit të veprimit me Vendimin Nr. 05 – 4060, datë 04.07.2023 është emëruar Grupi punues për hartimin e planit për zhvillim të edukimit shëndetësor në nivel spitalor për Sëmundjet kronike jo ngjitëse në përputhje me planin kombëtar të veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor me përfaqësues të institucioneve të ndryshme të përfshirë IKSHPK, MSH, QKUK, SP- GJAKOVË, SP- PEJË, QKMF – PEJË, QKMF – GJAKOVË, si dhe ekspertë nga Projekti IHS dhe AHQ. Gjithashtu me Vendimin Nr.05-4060/3, datë 23.10.2023 është plotësuar dhe ndryshuar Vendimi Nr. 05 – 4060, datë 04.07.2023 me përfaqësues nga SP i Gjakovës dhe IKSHPK-së. Ndërsa në punëtori janë ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Për hartimin e këtij plani janë mbajtur 7 punëtori të cilat janë mbështetur nga Projekti IHS. Fillimisht është mbajtur takimi i parë informues rreth procesit të vetëvlerësimit. Në punëtorinë e dytë të grupit punues janë dhënë instruksionet për vetëvlerësim dhe është bërë ndarja në dy grupe punuese (Spitali-Gjakovë – Grupi i parë dhe Spitali- Pejë – Grupi i dytë) për vetëvlerësimin e gjendjes momentale në këto spitale. Grupet punuese në bashkëpunim me IKSHPK dhe MSh-në si fasilitues dhe me mbështetjen e ekspertëve të IHS-së kanë zhvilluar procesin e Vetëvlerësimit.

2.1. Vlerësimi i situatës

Procesi i vetëvlerësimit është inicuar dhe realizuar nga anëtarët e grupit punues (GP) në dy spitalet e përgjithshme të Pejës dhe Gjakovës gjatë periudhës korrik - shtator të vitit 2023.

Gjatë vetëvlerësimit janë identifikuar elementet e matshme që janë të zbatueshme në spital. Situata aktuale e vlerësuar në spitalin e Pejës dhe Gjakovës tregon se spitalet zbatojnë masat e veçanta për të garantuar respektimin e të drejtave të pacientëve, gjithashtu ato janë të certifikuara si spitale mike të foshnjës.

Në spitalet e vlerësuara zbatohet Ligji kundër duhanit, dhe shitja e alkoolit dhe produkteve të duhanit është e ndaluar. Ankesat e pacientëve trajtohen vazhdimisht nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave po ashtu të dhënat e anketimit nga pacientët dhe familjet mbi

përceptimet e tyre për përvojën e kujdesit, përdoren për të përmirësuar mjedisin ku ofrohen shërbimet shëndetësore.

Programet e trajnimit të stafit janë të disponueshme, planifikohen në fillim të vitit dhe zbatohen gjatë tërë vitit, kurrikula e tyre përfshinë udhëzime për përmirësimin e aftësive komunikuese dhe përqëndrimin tek pacienti.

Spitali zvogëlon vëllimin dhe toksicitetin e mbetjeve të prodhuara nga sektori shëndetësor dhe zbaton opcionet më të shëndosha mjedisore të menaxhimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

Situata aktuale e vlerësuar në spitalin e Pejës dhe Gjakovës tregon se vizioni organizativ, misioni dhe deklaratat e vlerave pasqyrojnë një përkushtim të orientuar drejt shëndetit dhe përmirësimit, por duhet orientuar edhe në pjesën promovuese të shëndetit.

Gjakova: Spitali është i përkushtuar për të siguruar disponueshmërinë e infrastrukturës së nevojshme, ka burime njerëzore në dispozicion, posedon hapësirat për hapjen e këshillimores, pajisjet mungojnë dhe nuk ka buxhet të dedikuar për promovim shëndetësor. Deklarata e të drejtave të pacientit është lehtësisht e qasshme, e disponueshme në gjuhët kryesore të komunitetit në të gjitha ambientet e dukshme ku bie në kontakt me pacientin, ka nevojë që e njëjta të përsoset me fletëpalosje përcjellëse e cila do i ipet pacientit në hyrje dhe e njëjta ti transmetohet gjatë qëndrimit në Institucion.

Peja: Spitali ka buxhet të limituar për edukim të pacientëve, në veçanti nuk realizohet pagesë për aktivitetet e mbajtura, ka infermieret e angazhuar për edukim dhe këshillim të pacientëve, ka hapsirë të dedikuar për edukim por nuk ka kapacitet të madh, mungojnë mjetet dhe pajisjet për kryerjen e aktiviteteve promovuese të shëndetit. Deklarata e të drejtave të pacientit nuk është e ekspozuar në të gjitha dhomat e pacientëve. Reagimet e pacientëve dhe të familjes dhe të dhënat e anketës mbi përceptimet e tyre për përvojën e kujdesit janë përdorur për të përmirësuar mjedisin e kujdesit (përqëndrimi në fushat: siguria e pacientit, dinjiteti, të drejtat e pacientit, mirëpo ka kohë që nuk është aplikuar anketimi).

Fletëlëshimet jepen dhe vlerësohen por nuk i posedojnë të dhënat përcjellëse këshilluese për sëmundjen e caktuar. Në të ardhmen planifikohet të futen në funksion ku çdo pacienti do i ipet fletëpalosja përcjellëse me udhëzimet përkatëse se si të kujdeset pas hospitalizimit (lëshimit në shtëpi).

Spitalet ofrojnë shërbime këshillimi të shkurta ose intenzive në lidhje me faktorët kryesorë të rrezikut, të tillë si duhani, alkooli, dieta/ushqyerja dhe pasiviteti fizik. Por, nuk posedojnë procedurë të vlerësimit dhe nuk ka këshillimore dhe staf të dedikuar për këshillim që mund të bazohet në vlerësimet e individualizuara të nevojave të pacientit.

Me rastin e referimit, ekziston një procedurë për shkëmbimin e informacionit përkatës të pacientit në formë manuale në QKMF, Spitale dhe QKUK (nuk është integruar në TI-së, dhe ky hap është i domosdoshëm). Institucionit shëndetësor që bënë pranimin e pacientit i jepet, në kohën e duhur, një përmbledhje me shkrim e gjendjes së pacientit, nevojave shëndetësore dhe ndërhyrjeve të ofruara nga organizata referuese, por mungon informata

kthyesë pasi mungon sistemi i integruar i internetit brenda tre niveleve në QKMF, Spitale, QKUK.

Vëzhgimi dhe anketat në terren pasqyrojnë një mjedis të pastër mirëpo mund të punohet shumë për një mjedis më komod, në zgjerimin e pritoreve dhe krijimin e kushteve më komode përfshirë pajisjen e pritoreve me TV, broshura informuese, piktura dhe krijimi i një mjedisi më shtëpiak.

Spitali bashkëpunon me organizatat e shëndetit publik në mbledhjen e informacioneve mbi parandalimin e sëmundjeve dhe nevojat për promovimin e shëndetit në zonën së cilës i shërben, por nuk mund ti shfrytëzoj të dhënat e mbledhura për nevoja të përpilimit të politikave edukative pasi nuk ka ndonjë kthim informacioni nga instancat referuese si dhe procesi nuk është i digjitalizuar.

Fushat që duhen dukshëm të përmirësohen janë përgatitja e fletëpalosjeve për informim në gjuhët e komuniteteve.

Stafiti nuk i ofrohet trajnim për ndërgjegjësimin kulturor dhe nuk ofrohen shërbime ushqimore dhe fetare të përshtatshme për kulturën.

Në të dy spitalet forma e mbledhjes së të dhënave konform modelit të SPSH nuk është aplikuar deri më tani.

Spitalet janë të përkushtuar të fillojnë programin për promovim dhe edukim shëndetësor.

Planifikojnë të përditësojnë dhe rifillojnë anketimin e pacientëve rreth opinionit të tyre për shërbimet e ofruara shëndetësore dhe kënaqshmërinë e tyre me Institucionin.

2.2. Ecuria e punës

Procesi ka vazhduar në punëtoritë e radhës me spitalin e Gjakovës dhe spitalin e Pejës ku janë diskutuar rezultatet e vlerësimit të parë.

Grupet kanë qenë shumë të përkushtuar dhe të motivuar gjatë gjithë procesit të punës grupore. Kanë pasur bashkëpunim të mirëfilltë duke qenë vetëkritik. Grupet kanë punuar së bashku dhe kanë gjetur mënyra për t'i tejkaluar sfidat me sukses dhe si rezultat i përkushtimit dhe bashkëpunimit të tyre kanë arritur realizimin e qëllimeve të tyre.

Pas vetëvlerësimit, është realizuar nga Projekti IHS punëtori për përdorimin e Mjetit të Vetë-Vlerësimit për Spitalet dhe Shërbimet Shëndetësore Promovuese të Shëndetit nga Profesor Dr. Oliver Groene ekspert i Rrjetit Ndërkombëtar në Spitalet dhe Shërbimet Shëndetësore që Promovojnë Shëndetin dhe anëtar i Bordit Drejtues në OptiMedis AG.

Pastaj, është mbajtur punëtorja dy ditore ku është bërë përcaktimi i strategjisë për integrimin e edukimit shëndetësor në praktikat dhe rrjedhat e punës rutinë në kujdes.

Në punëtorinë e radhës treditore, bazuar në standardet e OBSH 2020 për Spitalet promovuese të shëndetit, janë hartuar aktivitetet konkrete për spitalin e Pejës dhe Gjakovës për vitin 2024 dhe të njëjtat janë kostuar. Gjithashtu janë definuar temat e programeve të trajnimit për personel të spitalit për edukim shëndetësor dhe promovim të shëndetit si dhe

është bërë përcaktimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të programit të edukimit shëndetësor në spitale.

Në punëtorinë e fundit është finalizuar Plani për zhvillim dhe edukim shëndetësor në nivel spitalor për Sëmundjet kronike jo ngjitëse në përputhje me planin kombëtar të veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor.

2.3. Mbikqyrja e procesit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara

Grupi punues ka përpiluar planin konkret të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024 në bazë të të cilit do të realizon mbikqyrjen e zbatimit të aktiviteteve me qëllim të arritjes së standardeve të përcaktuara për spitalin e Gjakovës dhe Pejës.

3. PLANI I AKTIVITETEVE VJETORE

PLANI PËR ZHVILLIM TË EDUKIMIT SHËNDETËSOR NË NIVEL SPITALOR PËR SËMUNDJET KRONIKE JO NGJITËSE NË PËRPUTHJE ME PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PROMOVIM DHE EDUKIM SHËNDETËSOR PËR VITIN 2024

I. Objektivi strategjik #1: PLANI PËR ZHVILLIM TË EDUKIMIT SHËNDETËSOR NË NIVEL SPITALOR PËR SËMUNDJET KRONIKE JO NGJITËSE NË PËRPUTHJE ME PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PROMOVIM DHE EDUKIM SHËNDETËSOR					
	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2023	Gjashtëmuji 2024	Caku 2024	
I. Objektivi strategjik #1: PLANI PËR ZHVILLIM TË EDUKIMIT SHËNDETËSOR NË NIVEL SPITALOR PËR SËMUNDJET KRONIKE JO NGJITËSE NË PËRPUTHJE ME PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PROMOVIM DHE EDUKIM SHËNDETËSOR	Arritja e 20 standardeve të plotësuara sipas OBSH për SPSH	7 standarde të OBSH të plotësuara	17 standarde të plotësuara	20 standarde të plotësuara	
Objektivi specifik 1.1 Standardi 1. Demonstrimi i angazhimeve organizative për SPSH, me dy nënstandartet: Lidershipi dhe Politika		10 standarde janë në proces	2 standarde të plotësuara	2 standarde të plotësuara	

Aktiviteti	Afat i zbatimit	Kosto total:					Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti/R rezultati	Ref. me dok.
		2023	T1	T2	T3	T4					
1.Koordinatorët e cilësisë adresojnë ndryshimet e nevojshme rreth përfshirjes së Promovimit dhe edukimit shëndetësor.	Tremujori i 4 i 2023	Nuk ka kosto shtesë	/	/	/	/	Buxheti spitalor	Sp Pejë, Gjakovë	MSH/IKSHPK	Plani i punës për vitin 2024 ka të përfshirë PESH	Stand ardi 1.1.3 SPSH
2.Përgatitja për anëtarësim në rrjetin e Spitaleve Promovuese të Shëndetit.	2024	1,000.00 euro	600.00 euro	400.00 euro	/	/	IHS	Spitalet /IHS	MSH	Spitalet (Pejë, Gjakovë) janë të anëtarësuar në rrjetin e Spitaleve Promovuese të Shëndetit	Stand ardi 1.1.3 SPSH
3.Sigurimi i inventarit për hapësirat e dedikuara (ambulancat specialistike, dhomat për edukimin shëndetësor të pacientëve në hapësirat e pritores (TV, pajisjet tjera përcjellëse, etj.).	2024	30,000.00 euro	15,000.00 euro	15,000.00 euro			IHS	Spitalet /IHS	MSH	Spitalet (Pejë, Gjakovë) janë të pajisura me inventarin për hapësirat e dedikuara (ambulancat	Stand ardi 1.2.3 SPSH

											specialistike , dhomat për edukimin shëndetësor të pacientëve në hapësirat e pritores (TV, pajisjet tjera përcjellëse, etj.).	
4.Inicimi për ndarjen e vijës buxhetore për PESH në spitalin e Pejës dhe spitalin e Gjakovës.	2024	Pa kosto shtese	/	/	/	/	Spitalet					Stand ardi 1.2.3 SPSH
5. Revidimi i përshkrimit të detyrave të punës të infermierëve të caktuar për PESH.	2024	5,450.00 euro	5,450.00 euro	/	/	/	IHS	Sp Pejë, Gjakovë	MSH/OIK			Stand ardi 1.2.3 SPSH
6. Hartimi i protokoleve të punës dhe PSO-ve. (4 PSO)	2024	10,000.00 euro	2,500.00 euro	2,500.00 euro	2,000.00 euro	2,000.00 euro	IHS	Sp Pejë, Gjakovë	MSH/IKSHPK	4 PSO të hartuara (PESH për Diabet dhe Hipertension në kuadër të repartit/ambulancës)		Stand ardi 1.2.3 SPSH

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1		€	€		€							
Nga të cilat kapitale		€	€		€							
Nga të cilat rrjedhëse												
Objektivi specifik 1.2 Standardi 2. Sigurimi i qasjes në shërbime me dy nënstandartet: E drejta dhe disponueshmëria dhe Pranueshmëria socio-kulturore								1 standard është i plotësuar 1 standard është në proces	2 standarde të plotësuara	3 standarde të plotësuara		
Aktiviteti	Afat i zbatimit	Kosto totale					Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti/R rezultati	Ref. me dok.	
		2023	T1	T2	T3	T4						
1.Krijimi i GP për hartim dhe përshtatje të kartës së të drejtave të pacientit në formë të fletushkës.	2024	5,450.00 euro	5,450.00 euro	/	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK IHS	Fletushkat e dizajnuara	Standardi 2.1.2 SPSH	
2.Shtypja e kartës së të drejtave të pacientëve me përkrahje të HIS.	2024	10,000 euro	10,000 euro	/	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK IHS	Numri i kartës së të drejtave të pacientëve	Standardi 2.1.2 SPSH	
3.Vendosja e kartës së të drejtave të pacientëve në faqen web të spitaleve.	2024	Brenda buxh	/	/	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK IHS	Karta e të drejtave të pacientëve e postuar në faqen web	Standardi 2.1.2 SPSH	

		etit									të spitalit të Gjakovës dhe spitalit të Pejës	
4.Trajnimi i stafit të Spitalit për ndërgjegjësime kulturore.	2024	30,00 0.00 euro	/	15,00 0.00 euro	/	15,000.00 euro	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK IHS	Të trajnuar afër 600 staf nga spitali i Gjakovës dhe rreth 600 staf nga spitali i Pejës	Standardi 2.3.1 SPSH	
5.Përpilimi i anketës për pacientë	2024	2,000.00 euro	2,000.00 euro	/	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK	Anketa e përpiluar	Standardi 2.3.2 SPSH	
6.Realizimi i anketës për pacientë	2024	3,000.00 euro	/	3,000.00 euro	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK	Anketa e realizuar, raporti i përgatitur	Standardi 2.3.2 SPSH	
7. Ndërtimi i receptionit në spital	2024	20,000.00 euro	2,000.00 euro	18,000.00 euro	/	/	Buxheti i Kosovës Donatorët	Spitali i Gjakovës dhe Pejës	MSH IKSHPK IHS	Vleresimi dhe projekti i hartuar Receptioni i përfunduar në dy spitalet	Standardi 2.3.2 SPSH	
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1		€	€			€						
Nga të cilat kapitale		€	€			€						
Nga të cilat rrjedhëse												

<p>Objektivi specifik 1.3 Standardi 3. Përmirësimi i përqendrimit të kujdesit shëndetësor me njerëzit në qendër dhe përfshirja e përdoruesve, me pesë nënstandardet: Përgjegjshmëri ndaj nevojave të kujdesit, Praktika e përgjegjshme e kujdesit, Komunikimi me pacientin dhe ofruesin, Mbështetja e ndryshimit të sjelljes së pacientit dhe fuqizimit të pacientit, Bashkëpunimi me ofruesit e kujdesit</p>		<p>4 standarde të plotësuara 5 standarde në proces</p>	<p>9 standarde të plotësuara</p>	<p>9 standarde të plotësuara</p>
---	--	--	----------------------------------	----------------------------------

Aktiviteti	Afat i zbatimit	Kosto totale						Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti/R rezultati	Ref. me dok.
		2023	T1	T2	T3	T4						
1.Instalimi i sistemit të intranetit (sigurimi i programit dhe moduli për intranet).	2024	30,000.00 euro	15,000.00 euro	15,000.00 euro	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Intranet funksional në të dy Spitalet	Standardi 3.1.2 SPSH	
2.Trajnimi i stafit të dy spitaleve për modulin për intranet	2024	5,000.00 euro	1,500.00 euro	2,000.00 euro	1,500.00 euro	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Stafi i të dy Spitave të trajnuar	Standardi 3.1.2 SPSH	

3.Rishikimi/përshtatja e pyetësorit të standardizuar i cili do përdoret në të dy spitalet, mbi përceptimet e pacientëve-familjarëve për përvojën e tyre në fushat: siguria, privatësia, dinjitet dhe të drejtat e pacientit.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Pyetësori i standardizuar	Standardi 3.2.1 SPSH
4.Mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Raporti i finalizuar i të dhënave	Standardi 3.2.1 SPSH
5.Formimi i komisionit të brendshëm në Spitalet për të parapërgatitur stafin e Akusherisë, neonatologjisë dhe ambulancën gjinekologjike për 10 hapat e të ushqyerit me qumësht të gjirit.	2024	5,450.00 euro	5,450.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Promovimi dhe edukimi të ushqyerjes me qumësht gjiri	Standardi 3.2.7 SPSH
6.Trajnimi i stafit për 10 hapat e të ushqyerit me gj.	2024	30,000.00 euro	15,000.00 euro	/	15,000.00 euro	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Stafi i trajnuar	Standardi 3.2.7 SPSH

7.Rifillimi i procesit të vlerësimit të jashtëm për SMF.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Certifikimi i Spitalve/SMF	Standardi 3.2.7 SPSH
8.Krijimi i komisionit të brendshëm monitorues.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Raporti i finalizuar	Standardi 3.2.8 SPSH
9.Vendosja e shenjzimit ne hapsirat e brendshme dhe jashtë objektit të Spitalit që ndalohet pirja e duhanit.	2024	5,000.00 euro	5,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Shenjzimi në çdo repart të Spitalit	Standardi 3.2.8 SPSH
10.Ridizajnimi i pyetësorit për pacientin dhe familjarët.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Matja e performancës së Spitaleve	Standardi 3.3.1 SPSH
11.Raporti i komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe veprimet e ndërmarra.	2024	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Masat disiplinore; Edukim plotësues;	Standardi 3.3.1 SPSH
12.Rishikimi dhe përditësimi i procedurave për shqyrtimin e ankesave (PSO).	2024	5,000.00 euro	5,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Hartmi i PSO	Standardi 3.3.1 SPSH

									Spitali i Pejës			
13.Përditësimi i planprogramit trajnues bazuar në gjetjet e vlerësimit të nevojave për trajnime të stafit shëndetësor.	2024	5,000.00 euro	5,000.00 euro	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Stafi i trajnuar	Standardi 3.3.2 SPSH
14.Organizimi i trajnimeve specifike për shkathtësi komunikuese për stafin e dy Spitaleve.	2024	20,000.00 euro	10,000.00 euro	/	10,000.00 euro	/	10,000.00 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Stafi i trajnuar	Standardi 3.3.2 SPSH
15. Hartimi i programeve për trajnimin e stafit dhe realizimi i trajnimeve.	2024	11,000.00 euro	6,500.00 euro	1,500.00 euro	1,500.00 euro	1,500.00 euro	1,500.00 euro	IHS	Sp. Peje, Gjakove	MSh/IKSHPK	Programet e trajnimit te hartuara dhe stafi i trajnuar 1 ToT - 6,500 Euro 7 trajnime - 4,500 Euro	Standardi 3.3.2 SPSH
16.Përpilimi i fletëpalosjeve me informata përcjellëse për mbështetje në ndryshim të sjelljes së pacientëve.	2024	20,000.00 euro	5,000.00 euro	5,000.00 euro	5,000.00 euro	5,000.00 euro	5,000.00 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Fletëpalosja e dizajnuar	Standardi 3.4.1 SPSH
17.Fletëlëshimi i shoqëruar	2024	Nuk	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i	MSh/Spitali i	MSh/IKShPK	Edukimi i pacientit	Standardi

me fletëpalosje përcjellëse me udhëzimet përkatëse se si të kujdeset pacienti pas lëshimit nga spitali.		ka kosto shtesë					Kosovë/Donatorët	Gjakovë/Spitali i Pejës			3.4.1 SPSH
18.Hartimi i formës së vlerësimit të nevojave të pacientit për stilin e shëndoshë të jetesës.	2024	3,000.00 euro	1,500.00 euro	1,500.00 euro			MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Check lista e dizajnuar	Standardi 3.4.2 SPSH
19.Rivendosja e dhomës për këshillim të pacientëve në hapësira të reja të spitalit të Pejës.	2024	10,000.00 euro	10,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Këshillimorja e krijuar	Standardi 3.4.2 SPSH
20.Adaptimi i hapësirës për funksionalizim të këshillimores për edukim të pacientëve në spitalin e Gjakovës.	2024	10,000.00 euro	10,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Këshillimorja e krijuar	Standardi 3.4.2 SPSH
21.Furnizimi me inventar dhe pajisje.	2024	10,000.00 euro	10,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Spitali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Këshillimorja funksionale	Standardi 3.4.2 SPSH
22.Trajnimi i stafit.	2024	8,750.00	8,750.00	/	/	/	MSh/Buxheti i	MSh/Spitali i	MSh/IKShPK/HS	Stafi i trajnuar	Standardi

		euro	euro					Kosovë/Do natorët	Gjakov ë/ Spitali i Pejës			3.4.2 SPSH
23. Këshillimi dhe edukimi i pacientit.	2024	5,000.00 euro	1,250.00 euro	1,250.00 euro	1,250.00 euro	1,250.00 euro	1,250.00 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Do natorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Edukimi i pacientit	Standardi 3.4.5 SPSH
24. Anketimi i pacientit.	2024	2,000.00 euro	2,000.00 euro	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Do natorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Përgatitja e raportit	Standardi 3.4.5 SPSH
25. Raporti nga Anketimi i pacientit.	2024	2,000.00 euro	/	2,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Do natorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Performanca e Spitalit	Standardi 3.4.5 SPSH
26. Hartimi i planit për adresimin e të gjeturave.	2024	2,000.00 euro	/	/	2,000.00 euro	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Do natorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK	Plani i finalizur	Standardi 3.4.5 SPSH
27. Krijimi i modulit i cili mundëson shkëmbimin e informatave të pacientëve duke përfshirë informatën	2024	1,000.00 euro	1,000.00 euro	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Do natorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i	MSh/IKShPK/HS	Moduli i funksionalizuar	Standardi 3.6.2 SPSH

kthyese.									Pejës			
28.Trajnimi i stafit për përdorim të sistemit të TI.	2024	8,750.00 euro	4,375.00 euro	/	4,375.00 euro	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Stafi trajnuar	Standardi 3.6.2 SPSH	
29.Informimi i pacientit dhe familjarit për përdorim të sistemit të TI.	2024	2,000.00 euro	500.00 euro	500.00 euro	500.00 euro	500.00 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Edukimi i pacientit/familjarit	Standardi 3.6.2 SPSH	
30.Monitorimi i zbatimit të modulit të TI.	2024	5,450.00 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Arritëshmëria e zbatimit	Standardi 3.6.2 SPSH	
31.Hartimi i modulit i cili mundëson shkëmbimin e informatave të pacientëve duke përfshirë informatën kthyese.	2024	3,000.00 euro	3,000.00 euro	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Moduli i funksionalizur	Standardi 3.6.3 SPSH	
32.Trajnimi i stafit për përdorim të sistemit të TI.	2024	8,750.00 euro	2,187.50 euro	2,187.50 euro	2,187.50 euro	2,187.50 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i	MSh/IKShPK/HS	Stafi i trajnuar	Standardi 3.6.3 SPSH	

						o	o		Pejës			
33.Informimi i pacientit dhe familjarit për përdorim të sistemit të TI.	2024	Nuk ka kosto shtesë	/	/	/	/	/	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Edukimi i pacienti/familjarit	Standardi 3.6.3 SPSH
34.Monitorimi i zbatimit të modulit për shkëmbim të informatave.	2024	5,450.00 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	1,362.50 euro	MSh/Buxheti i Kosovë/Donatorët	MSh/Sptiali i Gjakovë/Spitali i Pejës	MSh/IKShPK/HS	Komisini monitorues	Standardi 3.6.3 SPSH
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1		€	€			€						
Nga të cilat kapitale		€	€			€						
Nga të cilat rrjedhëse												
Objektivi specifik 1.4 Standardi 4. Krijimi i një vendi të shëndetshëm pune dhe një mjedisi të shëndetshëm me një nënstandard: Mjedisi i shëndetshëm								1 standard i plotësuar 1 standard në proces	2 standarde të plotësuara	2 standarde të plotësuara		
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kosto totale					Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti/R rezultati	Ref. me dok.	
		2023	T1	T2	T3	T4						

1.Pritore multifunkcionale me standarde evropiane (ulëse komode, tavolinë, shtande për informim, edukim, komunikim (IEK).	2024	20,00 0.00 euro	/	10,00 0.00 euro	/	10, 000 .00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK Donatorët	Pritorja komode dhe funksionale	Standardi 4.2.3 SPSH
2.TV me video spote promovuese +USB 1 TB.	2024	5,000 .00 euro	/	2,500 .00 euro	/	2,5 00. 00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK IHS	TV dhe USB të vendosura në pritore	Standardi 4.2.3 SPSH
3.Postera me mesazhe për promovimin e shëndetit.	2024	2,000 .00 euro	500. 00 euro	500.0 0 euro	500 .00 eur o	500 .00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK IHS	Posterët e vendosura në pritore	Standardi 4.2.3 SPSH
4.Vendosja e shenjave për ndalim të ndotjes akustike, shenja për ndalim të përdorimit të celularit me zë të lartë dhe shenja për qetësi dhe ndalimi i xhirimit dhe fotografimit.	2024	2,000 .00 euro	500. 00 euro	500.0 0 euro	500 .00 eur o	500 .00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK IHS	Shenjëzimet e vendosura	Standardi 4.2.7 SPSH
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1		€	€		€						
Nga të cilat kapitale		€	€		€						

Aktiviteti		Afat i zbatimit	Kosto totale					Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti/R rezultati	Ref. me dok.
			2023	T1	T2	T3	T4					
Objektivi specifik 1.5 Standardi 5. Promovimi i shëndetit në një shoqëri më të gjërë me dy nënstandarde: Nevojat shëndetësore të popullatës dhe Shëndeti mjedisor								1 standard i plotësuar 1 standard në proces	2 standarde të plotësuara	2 standarde të plotësuara		
1.Krijimi i mekanizmit për shfrytëzimin e të dhënave të mbledhura brenda spitalit për nevoja të përpilimit të politikave edukative.		2024	Pa kostosh	/	/	/	/	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK	Ekipi i krijuar	Standardi 5.1.3 SPSH
2.Krijimi i mekanizmit për sigurimin e informatave kthyesë nga IKShPK dhe QRSHP.		2024	4,000.00 euro	1,000.00 euro	1,000.00 euro	1,000.00 euro	1,000.00 euro	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK IHS	Takimet e realizuara	Standardi 5.1.3 SPSH
3.Trajnimi i stafit për përdorim të sistemit të TI.		2024	Pa kostosh	/	/	/	/	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjithshëm	MSh IKShPK IHS	Mekanizimi i krijuar	Standardi 5.1.3 SPSH
4.Zbatimi i PSO-ve për		2024	20,00	5,00	5,000	5,0	5,0	Buxheti i Kosovës,	Spitali i Përgjith	MSh IKShPK	Numri i trajnimeve	Standardi

menaxhim të mbetjeve spitalore.		0.00 euro	0.00 euro	.00 euro	00. 00 eur o	00. 00 eur o	Donatorët	shëm		të realizuara	5.3.2 SPSH
5.Monitorimi i zbatimit të PSO-ve nga Komisioni për kontrollin e infeksioneve spitalore, përmes observimit.	2024	10,00 0.00 euro	/	5,000 .00 euro	/	5,0 00. 00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjith shëm	MSh IKShPK	PSO-të e zbatuara	Stand ardi 5.3.2 SPSH
6.Monitorimi i zbatimit të PSO-ve nga Komisioni për kontrollin e infeksioneve spitalore, përmes observimit	2024	2,000 .00 euro	500. 00 euro	500.0 0 euro	500 .00 eur o	500 .00 eur o	Buxheti i Kosovës, Donatorët	Spitali i Përgjith shëm	MSh IKShPK	Raporti me rezultatet e monitorimit	Stand ardi 5.3.2 SPSH
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1		€	€		€						
Nga të cilat kapitale		€	€		€						
Nga të cilat rrjedhëse											